



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.27.dt.03.03.2000

MBI

**KALIMIN E SEKTORIT TE PRODHIMIT TE ASFALTO-BETONI, REPARTIT
FRANTOSE DHE PLLAKAVE BITUMINOZE, TE NDERMARRJES
KOMUNALE TE RRUGEVE NGA SEKTORI BUXHETOR NE GJYSEM
BUXHETOR ME (VETFINANCIM)**

Këshilli i Bashkisë i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.03.03.2000, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga D.P.P.SH “Për kalimin e sektorit të prodhimit të asfaltobetonit, repartit frantojes dhe pllakave bituminoze nga sektori buxhetorë në gjysëm buxhetor me (vetfinancim), bazuar në ligjin 7582 dt.13.07.1992 neni 1, 2, neni 3 pika 1, 2 neni 4, neni 6 pika 1, 2, 3 si dhe V.K.M nr.317 dt.08.07.1999, pika 2, 3, 4 dhe 7 “Për funksionimin e ndërmarrjeve shtetore” si dhe ligji 7572 neni 14 pika 9 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”

V E N D O S I

1. Të miratohet kalimi i sektorit të prodhimit të asfalto-betoni, repartit frantojes dhe pllakave bituminoze, të ndërmarrjes komunale të rrugëve nga sektori buxhetor në gjysëm buxhetor me (vetfinancim)
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e P.P.P.SH dhe Drejtoria e Financës
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

